

**SUBJEKTI**  
**“EDILE VESELI - COSTRUCSION”**  
**SH.P.K**

**NIPT K64818201U**

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:**

**INDUSTRIA MINERARE**

<b>ID 3.7</b>	<b>NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORET</b>
<b>ID 3.11</b>	<b>PRODHIMI DHE FRAKSIONIMI I PRODUKTEVE MINERARE JOMETALIKE.</b>

*Referuar shtojces 1 te ligjit 108/2024 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.*

**VENDNDODHJA:**

**Durrës, Krujë, Objekti “Borizanë”, Leja minerare nr.  
Nr.1256/1.**




## PËRMBAJTJA E RAPORTIT


1.	PROFILI I OPERATORIT.....	3
2.	QËLLIMI I RAPORTIT.....	5
3.	OBJEKTIVAT E RAPORTIT.....	6
4.	VENDNDODHJA E AKTIVITETIT.....	6
5.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT.....	7
6.	IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	18
7.	MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	22
8.	MONITORIMI.....	24

## 1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti "EDILE VESELI - COSTRUCSION" është i regjistruar në QKB me Formë Ligjore si Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), i pajisur me Nr. Identifikimi NIPT K64818201U, me Administrator Z. Agim Veseli.

Subjekti zotëron Akt Miratimin Nr.1256/1, Datë 10.08.2018 mbi veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineralit të Gurit Gëlqeror, Objekti "Borizanë", Krujë, Qarku Durrës.

	
REPUBLICA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	
Nr. <u>9218</u> prot.	Tiranë, më <u>10.08</u> 2018
<b>AKT – MIRATIMI NR. 1256/1</b>	
<p>Për Aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për Leje Minerare Shfrytëzimi, me numër çështje LC-8075-04-2018 dt 12.04.2018, dorëzuar nga ana e subjektit "EDILE VESELI – COSTRUCSION" Sh.p.k, për shtyrje afati të Lejes Minerare të Shfrytëzimit nr.1256 datë 15/10/2008, zotëruar nga ana e subjektit "EDILE VESELI – COSTRUCSION" Sh.p.k (leje e mëparëshme) për mineralin Gur Gëlqeror, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin "Borizanë", Krujë, Qarku Durrës.</p>	
1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:	
a) Emri i subjektit: " EDILE VESELI – COSTRUCSION " Sh.p.k;	
b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes: z.Agim Veseli	
c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja: Gur Gëlqeror.	
d) Adresa e selisë së subjektit: Durrës Thumanë, Fushë Thumanë, Fshati Borizanë, vend Gurore, zona kadastrale 1247, pasuria nr.1.	
e) Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: z.Agim Veseli.	
f) Nr. telefonit /faksit: Cel; 068 62 63 920;	
g) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti: Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, Qarku Durrës.	
h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik; Bashkim Berberi, ing.miniere, pajisur me leje profesionale, nr.155 dt 19/06/2012.	
i) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: pa afat.	
2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 24, dhe kreun e IV të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej 10 vjet, me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 (dhjetë) vjet, me kërkesë të zotëruesit të lejes së paku 180 (njëqindtëtdhjetë) ditë kalendarike para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë.) nga data efektive e dhënies së lejes për shfrytëzim.	
3. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineralit;	
• Gur Gëlqeror,	
që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.	
4. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë;	
	
Adresa: Rr. " Abdli Toptani", Nr.1 Tiranë, Faqja web: <a href="http://www.infrastruktura.gov.al">http://www.infrastruktura.gov.al</a>	




## 2. QËLLIMI I RAPORTIT

Subjekti paraqet këtë raport, sepse kërkon të aplikojë për leje mjedisi Tip B për aktivitetin:

### INDUSTRIA MINERARE

ID 3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret
ID 3.11	Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerare jometalike.

Referuar shtojces 1 te ligjit 108/2024 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR.

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 723/13 Prot. Tiranë, më 15.07 2025

Lënda: Kthim përgjigje

**"EDILE VESELI – CONSTRUCTION"**

Qarku Durrës, Thumanë, Fushë Thumanë, Borizanë, Vend Furore, Zona Kadastrale 1247, Pasuria Nr.1


Në përgjigje të kërkesës suaj regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Nr.7236/2Prot., datë 14.07.2025, me lëndë: "Kthim përgjigje", Ju bëjmë me dije se:

Në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", për sipërfaqen S=0.046km<sup>2</sup> sipas përcaktimeve të AKBN-së ku citohet se "Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti mineral i shfrytëzimit ndodhet brenda sipërfaqes së lejes minerare të shfrytëzimit me Nr.9118/1Prot., date 10.08.2018 me Akt – Miratimi Nr. 1256/1, nuk duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, pasi është sipërfaqe e shfrytëzuar.

Ju informojmë se aplikimi për Leje Mjedisit Tipi A ose B kryhet sipas përcaktimeve të kreu II Leje Tipi A ose kreu III Leje Tipi B, të VKM Nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", i ndryshuar.

Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën, nëpërmjet QKB-së, sistemit online, referuar Ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr.538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
Arta Dollani



---

Adresa: Rruga "Sami Frashëri" Nr.4, Tirana, - Tel/Fax 04 2 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)

1

### 3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT

1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis (Emetimet në ajër, Gjenerimi i zhurmave; Ndikimi në florë/faunë; Mbetjet e gjeneruara; Ndikimi social-ekonomik; Ndikimi në cilësinë e jetës në qendrat e banuara; Ndikim në peisazhin e zonës).
2. Gjetja e alternativave që janë me miqësore me mjedisin dhe propozimi i masave të duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative gjatë zbatimit të aktivitetit.
3. Lehtësimi i infomimit të publikut dhe organeve vendim-marrëse mjedisore, lidhur me zbatimin e aktivitetit.

### 4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në adresën: Durrës, Krujë, Objekti "Borizanë", Leja minerare nr. Nr.1256/1.

Zona ku do të zhvillohet projekti është pjesë e Njësisë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, Qarku Durrës.

Koordinatat e vendndodhjes se aktivitetit sipas Sistemit GAUSS KRUGER janë si më poshtë:

Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti mineralar i shfrytëzimit


**Sip= 0.046 km<sup>2</sup>**

	E	N
1.	4393850	4601130
2.	4393938	4601181
3.	4393981	4601150
4.	4394078	4601227
5.	4394172	4601089
6.	4394000	4600944

Sipërfaqja e shesh-depozitimit të sterileve dhe të mineralit

**Sip= 0.0022 km<sup>2</sup> ose 0.22ha**

	E	N
1.	4393780	4601105
2.	4393771	4601138
3.	4393834	4601154
4.	4393850	4601130



## 5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

ID 3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guoret
--------	---

Zgjedhja e sistemit të shfrytëzimit është kompleksiteti i punimeve të hapjes, përgatitjes, zbulimit dhe shfrytëzimit të mineralit sipas një programimi dhe pa rreziqe për jetën e njerëzve.

**Sistemi i zgjedhur i shfrytëzimit siguron :**

- Nxjerrjen në volum e cilesi të mineralit që kerkohet për tu prodhuar në dite, muaj e vite me leverdi ekonomike e siguri maksimale në punë
- Efektivitet të lartë të shfrytëzimit të vendburimit dhe përcakton tipin e mjetit të ngarkimit, transportit, parrasat e karrieres, elementet kryesore gjeometrik, si dhe treguesit tekniko – ekonomik të punës në karriere.

**Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit të këtij vendburimi janë marr në konsideratë:**

- Konditat tekniko - minerare të vendburimit,
- Menyra e ngarkimit, transportit dhe depozitimit të mbuleses në zbulim

- *Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj*
- *Mjetet e ngarkimit qe parashikohen te perdoren ne zbulim dhe prodhim*
- *Menyra e rrezimit te mineralit*

**Bazuar ne faktoret e mesiperme shfrytezimi i ketij objekti do te behet duke aplikuar sistemin e shfrytezimit me transport.**

Sistemi i shfrytezimit me transport eshte universal, pasi pershtatet me shtrirjen e vendburimit, relievit te siperfaqes dhe fortesise te shkembinjve.

Skemat teknologjike e sistemit te shfrytezimit me transport jane te ndryshme, por ne kete objekt rekomandohet perdorimi i skemes se shfrytezimit me transport me automjete per zhvendosjen e mbuleses se padobishme per ne sheshet e depozitimit dhe mineralit ne destinacionin e perpunimit.

*Elementet kryesore te sistemit jane:*

- *Lartesia e shkalleve*
- *Gjeresia e hyrjes*
- *Gjatesia e bllokut*
- *Kendi i pjerresise se shkalleve te punes*

Elementet e sistemit jane percaktuar duke marre ne konsiderate kushtet gjeologjike – minerare, kushtet teknike dhe arritjet ne teknologjine e prodhimit, te mjeteve te shpimit, ngarkimit, transportit etj.

Qe sistemi te jete sa me efektiv kerkohet qe te sinkronizohen ne momentin e zgjedhjes tipi dhe karakteristikat e mjetit te shpimit, ngarkimit dhe transportit ne menyre te tille qe kryerja e njerit proces te mos pengoje ne kohe proceset e tjera.

Eshte pranuar qe lartesia e shkalles te jete 10 m, dhe shpati i shkalles te kete pjerresi 70 - 72°, si rrjedhoje edhe pjerresia e puseve te shpimit do te jete 70 - 72°.

Gjeresia e shesheve te punes pranohet 30 – 35 m, duke plasur njeheresh ngarkesat ne disa rradhe pusesh. Para plasjes se minave, qe si rregull konsiderohen plasje masive, masa e shkruferuar ka nje perhapje nga 15 – 20 m deri ne 30 metra e mjaftueshme si sasi per pune pa nderprerje te ekskavatorit. Ne cdo shkalle puna eshte e pavarur nga puna ne nje shkalle tjeter per nxjerrjen e mineralit. Pra shfrytezimi mund te organizohet ne dy, tre ose me shume shkalle njekohesisht duke respektuar distancat e rregullores se sigurimit teknik, qe diferencon avancimin e nje shkalle me siper ne relacion me shkallen me poshte. Si rregull balli i shkalles se siperme duhet te jete 15 – 20m me i avancuar se balli i shkalles me poshte.

Automjetet qe do te transportojne mineralin dhe mbulesen e padobishme afrohen me rruge unazore. Ato do te kene aftesi transportuese 15 – 30 ton dhe levizin me shpejtesi mesatare 20 km/ore me ngarkese me rruge ne zbritje ne drejtim te shesheve te depozitimit ose ne drejtim te konsumatorit.

Per te ulur ne minimum vonesat ne ngarkim, transport, shkarkim si dhe vonesat gjate rruges, drejtuesi teknik I punimeve harton skemen teknologjike te proceseve te punes duke

paracaktuar (normuar) kohën për kryerjen e çdo operacioni pune, siç janë: afrimi i mjeteve pranë ekskavatorit ngarkimi, transporti, shkarkimi, shpimi i puseve të minave, mbushja me lende plasese, shperthimi etj. Është projektuar që të gjitha proceset e punës të jenë të mekanizuara.

Zbatimi sa më rigoroz i kryerjes së proceseve teknologjike ndihmojnë në organizimin e prodhimit në karriere dhe sigurojnë përmirësimin e treguesve bazë të sistemit të shfrytëzimit me transport.

Rritja e efektivitetit të sistemit kërkon zbatimin e një disipline të rreptë teknike në punë, shërbimet operative dhe riparimet kapitalesipas një grafiku të hartuar me parë, sigurimi i fronteve rezerve të punës në karriere, furnizimi i rregullt me materiale teknike si mjete pune, pjese ndërrimi rezerve etj.

### **ELEMENTET E SISTEMIT TË SHFRYTËZIMIT**

#### **❖ Lartësia e shkallës**

Lartësia e shkallës përcaktohet duke marrë parasysh sigurinë në punë, vetitë fiziko – mekanike të shkëmbinjve, tipin e mjetit të rrezimit, ngarkimit dhe transportit që do të perdoret.

Me rritjen e lartësisë së shkallës, pakesohet numri i shkalleve në karriere, shkurtohet gjatësia e përgjithshme e rrugëve të transportit, ulen kostojat për mirëmbajtjen e tyre, rritet prodhueshmëria e ekskavatorit si rezultat i uljes së numrit të zhvendosjeve të tyre në frontin e punës, shkurtohet vëllimi i punimeve të shpimit në saj të rritjes së largësisë në mes puseve të shpimit.

Rritja pa llogari e lartësisë në shkallë krijon rrezikun e rreshqitjes së shpatëve të shkallës, dhe rritjen e numrit të blloqeve që i nënshtrohen procesit të ricoptimit.

Në rastin e shfrytëzimit të shkëmbinjve me forcë mbi mesatare, me shkrihim paraprak, lartësia e shkallës mund të jetë më e madhe se lartësia e kapjes së ekskavatorit, por jo më shumë se 1.5 herë lartësia e kapjes së koves së ekskavatorit. Në rastin konkret lartësia e shkallës është pranuar 10 m, që është e rekomandueshme nga literatura për vendburimet që shfrytëzohen në shpatë mali të pjerreta.

I rekomandohet shoqërisë që në funksion të mjetit të shpimit, ngarkimit, dhe transportit të ndryshojë lartësinë e shkallës nga 10 m në 15 deri 20 meter duke e shoqëruar këtë ndryshim me pasaportat teknike përkatëse.

#### **❖ Gjerësia e sheshit të punës në shkallë**

Në rastin e përdorimit të transportit automobilistik mund të llogaritet:

Në rastin kur automjeti e bën kthesën në anë të ekskavatorit gjerësia minimale e sheshit të punës diktohet nga:

- *A – gjerësia e hyrjes së ekskavatorit*
- *C – largësia ndërmjet buzës së poshteme të masës së shkrihuar të shkëmbit ose buzës së poshteme të shkallës dhe aksit të rrugës së levizjes së automjeteve*
- *R – rrezja e kthesës së automjeteve*

- $C_1$  – largësia nga aksi i rruges deri te linja e shembjes se mundeshme te shkalles (brezi i sigurise)
- $B$  - Gjerësia e brezit te sigurise mbi te cilin ndalohet vendosja e paisjeve te shpimit, transportit dhe ngarkimit

$$L_1 = A + C + 2R + C_1 + B$$

$$A \leq 1.5 R_{ke} = 11 \text{ m}$$

$$C = K/2 + 1 = 3/2 + 1 = 2.5$$

$K$  – Gjerësia e karrocere se mjetit te transportit e pranuar 3m

$$R = 1.2R_{min} = 1.2 \times 10 = 12 \text{ m}$$

$R_{min}$  – rrezja minimale e kthimit e pranuar 10 m

$$C_1 = K/2 + 1.5 = 3/2 + 1.5 = 3 \text{ m}$$

$$B = H(\cot\beta + \cot\alpha) = 10(0.509 - 0.364) = 1.45 \text{ m}$$

$H$  – lartësia e shkalles

$\beta$  – kendi i qendrueshmerise se shpatit i pranuar  $63^\circ$

$\alpha$  – kendi i pjerrtise se shpatit te shkalles i pranuar  $70^\circ$

Ne perfundim kemi:

$$L_1 = A + C + 2R + C_1 + B = 11 + 2.5 + 24 + 3 + 1.65 = 44.95$$

#### ❖ Gjerësia e hyrjes ne transhe

Gjerësia e hyrjes ne shkembinj te forte varet nga numri i rradheve te puseve te minave, i cili ne rastin e ketij projekti rekomandohet te jete dy ose tre. Per vendosje te puseve ne nje rradhe, gjerësia e hyrjes ne masiv eshte e barabarte me vijen e rezistences me te vogel marre ne dysHEME te shkalles. Ne rastin e ketij projekti kemi:

$$A = W + (n - 1) L_1 \quad \text{ku :}$$

- $W$  – vija e rezistences me te vogel
- $W_1$  – largësia ndermjet rradheve te puseve ( $W_1 = a$ )
- $a$  – largësia ndernjet puseve te minave ( $a = mw$ )
- $m$  – koeficienti i afrimit te ngarkeses se minave, ne rastin konkret pranohet 0.6 – 0.8

Gjerësia e brezit te shkruferuar fillon nga buza e poshteme e shkalles ne te cilen plasin minat, deri ne afersi te aksit te rruges ku levizin mjetet e transportit dhe percaktohet me matje te drejtperdrejte ose llogaritet:

$$X = A \left( 2K_{sh} \frac{H}{h} - 1 \right) \quad \text{ku :}$$

- *Ksh* - koeficienti i shkruferimit te shkembinjve
- H – lartesia e shkalles
- H – lartesia e mases se shkruferuar pas plasjes se minave ( $h = 0.8 - 0.9$ )H

Largesia nga buza e poshteme e mases se shkruferuar ose buzes se poshteme te shkalles dhe aksit te rruges se levizjes se auomjeteve llogaritet:

$$C = \frac{K}{2} + 1 \quad \text{ku :}$$

- K – gjeresia e karrocise se automjetit

#### ❖ **Blloku dhe gjatesia e frontit te punes**

Gjatesia e bllokut ne shkembinj te forte varion nga 200-300m ne 400-500m.

Fronti i shfrytezimit te mineralit perfaqeson gjatesine totale te fronteve te shkalleve ne nxjerrje minerali. Shpejtesia e zhvendosjes se fronteve ne njesi kohe (muaj, vite) perfaqson intesitetin e shfrytezimit te vendburimit. Zakonisht zhvendosja vjetore fillon me 10-15m deri ne 250 m/vit.

### **PERSHKRIM I PROGRAMIT TE SHFRYTEZIMIT**

#### ❖ **Punimet e rrezimit ne prodhim e zbulimin e mineralit.**

Fortesia e shkembinjve eshte e tille qe ben te domosdoshem perdorimin e punimeve me lende plasese. Prodhimi i mineralit ne karriere eshte projektuar deri ne 50000 m<sup>3</sup>/vit, duke rezervuar te drejten e shoqerise qe ne funksion te kerkesave te tregut te argumentojne rritjen e vellimit te prodhimit ose ne mungese tregu uljen e tij, ne programet vjetore qe harton dhe miraton ne organet pergjegjese .

Ne projekt pashaportat e shpim plasjes i jane referuar sigurimit te prodhimit mineralit prej 50000 m<sup>3</sup>/vit,

Punimet e shpim-plasjes ne prodhimin e mineralit diktohen nga keta faktore:

- *Domosdoshmeria e perdorimit te lendeve plasese per rrezimin e shkembinjve me fortesi mbi-mesatare.*
- *Karakteristikat gjeomekanike te pakos produktive.*

Ne funksion te ketyre faktoreve jane projektuar dy pashaporta shfrytezimi:


- *Per fazen fillestare te hapjes se gjysem transeve dhe ricoptimin e materialit te prodhuar, shpimi i birave do te behet me cekic shpues pneumatik dore.*
- *Per sigurimin e prodhimit ditor shpimi i birave do te behet me puse sondash me diameter 100m/m.*

#### **Rrezimi me bira marteli**

Rrezimi me bira marteli do te perdoret ne hapjen e rrugeve dhe transeve, pergatitjen e fillimit te shkalles, nivelimin e shesheve te punes, ricoptimin e mineralit me permasa te medha.

Ne rastin e rrezimit me bira marteli parametrat e pasaportes se shpim – plasjes do te jene:

· Lartesia e shkalles	<b>10m</b>
· Lartesia e nenshkalles	<b>2 m</b>
· Gjatesia e bires	<b>2.4 ml</b>
· Diametri i bires	<b>38 - 42 mm</b>
· Kendi i skarpates	<b>70-72°</b>
· Distanca nga bira ne bira	<b>1.5 m</b>
· Distanca nga buza e siperme e skarpates	<b>1.3 m</b>
· Vija e rezistences me te vogel 2.03	<b>2.03 m</b>
· Ngarkesa e Lendes Plasese per bira	<b>1.5 kg</b>
· Volumi maksimal i hedhur bira	<b>6 m<sup>3</sup></b>
· Konsumi specifik i lendes plasese	<b>0.25 kg/m<sup>3</sup></b>
· Gjatesia e ciklit	<b>25 m</b>
· Numri i rreshtave	<b>2</b>
· Numri maksimal i birave ne nje shperthim	<b>32 cope</b>
· Menyra e shperthimit	<b>me zjarr ose elektrike</b>
· Volumi i siguruar ne nje cikel	<b>192 m<sup>3</sup></b>



### **Shenim**

*Llogaritjet e mesiperme jene orientuese. Drejtuesi teknik i punimeve ne cdo plasje harton pashaportat e shpim plasjes ne funksion te gjendjes aktuale te frontit te punes*

### **Rrezimi me puse sonde**


Kjo metode perdoret gjeresisht ne frontet e punes per hapjen e transheve, ne frontet e shfrytezimit ose ne cdo front tjetër pune. Ne shkallen qe i nenshtrohet shperthimit shpohen pusët e minave per vendosjen e ngarkesave.

Pusët mund te shpohen vertikal ose te pjerret. Diametri i pusit te shpimit zgjidhet duke marre ne konsiderate lartesine e shkalles, vetite fiziko-mekanike te mineralit dhe vetite e lendes plasese.

Diametri i pusit per lartesi shkalle 10 m te jete 100 mm. Per shpimin e puseve te minave ne frontin e prodhimit do te perdoret sonde vete-levizese me sistem ecje me zinxhira e cila shpon puse me thellesi deri 30 m, me diameter 100 mmme kende shpimi deri ne 360°. Drejtimi i birave te sondes ne shkallet e karrieres do te jete vertikal dhe i pjerret, sic jane paraqitur ne anen grafike.

#### Parametrat e pasaportes (rrezimi me puse sonde)

Lartesia e shkalles	10m
Gjatesia e bires	11 m
Tejshpimi	1 m
Diametri i pusit sondes	100 mm
Kendi i skarpates	70 -72°
Distanca midis puseve	3 m
Distanca e pusit nga buza e siperme e skarpates	3 – 3.5 m
Distanca midis rreshtave te puseve	2.5 - 3 m
Vija e rezistences me te vogel	7.14 m
Ngarkesa e Lendes Plasese per pus	57 kg
Volumi mesatar i hedhur per pus sonde	214 m <sup>3</sup>
Konsumi specifik i lendes plasese	0.25 kg/m <sup>3</sup>
Menyra e shperthimit	elektrike
Numri i vijave te shperthimit	2
Numri i kapsollave per pus	2 cope
Koeficienti i afrimit midis ngarkesave te lendes plasese	0.9 m
Gjatesia e taposjes	3.7 m
Gjatesia e ngarkeses me lende plasese	7.3 m



### MBUSHJA E PUSEVE TE SONDES ME LENDE PLASESE, TAPOSJA DHE SHPERTHIMI I TYRE.

Shperthimi i puseve te sondes do te behet ne dy menyra :

- Shperthimi me kapsolla elektrike milisekondare te lidhura ne seri me kohe vonese 25ms ne rreshtin pasardhes, kur shperthehen njeheresh disa rreshta.
- Shperthimi i rrjetit elektrik do te behet me aparat shperthimi.

**Ngarkesa e lendes plasese qe vendoset ne puset e sondave kur shperthimi behet elektrik, perbehet nga :**

- Ngarkesa e bazes me lende plasese.
- Ngarkesa e kollones me lende plasese.
- Kapsollet elektrike.
- Rrjeti i shperthimit.

Ngarkesa e bazes eshte ngarkesa donatore e cila eshte lende plasese me e fuqishme se ngarkesa e vendosur ne pusin e sondes. Ngarkesa donatore se bashku me kapsollat vendosen ne fillim te pusit, ne mes, ose ne fund te tij. Lidhja e kapsollave elektrike me ngarkesen donatore behet duke u lidhur me njera tjetren dhe duke i forcuar me natribant per te mos lejuar shkeputjen e kapsollave nga lenda plasese.

Ngarkesa e kollones me lende plasese perbehet nga lenda plasese e llogaritur per shkiftimin e shkembit. Pjesa e mbetur e pusit te sondes taposet me pluhur shkambi i prodhuar gjate shpimit te sondes ose me argjile te cilat futen me pas dhe ngjishen.

Skemat e lidhjes se ngarkesave te vendosura ne puset e sondave ne nje ose me shume rreshta jane te shumte perdorimi i te cilave varet nga:

- *Siperfaqja e sheshit te shkalles se karrieres.*
- *Largesia e frontit te prodhimit ku eshte vendosur ngarkesa e lendeve nga objektet siperfaqesore.*
- *Permasat e copave te shkembit qe kerkohet mbas shperthimit.*

***Ngarkesa e lendes plasese me puse sonde kur shperthimi behet me fitil ndezes perbehet nga :***

- *Ngarkesa e bazes me lende plasese*
- *Ngarkesa e kollones me lende plasese*
- *Fitili ndezes*
- *Ngadalesuesit*
- *Kapsollet e zakonshem*
- *Fitil i zakonshem*

Fitili ndezes lidhet me ngarkesen e bazes se lendes plasese dhe futet ne pusin e sondes ne te gjithë ngarkesen e sondes nga fundi i saj deri ne siperfaqe. Lidhja e fitilit me fisheket e lendes plasese behet ne pjesen e jashtme te tyre, duke u nastruar me natribant per te mos lejuar shkeputjen.

Pas futjes se fitilit ndezes me fishekun e lendes plasese, ne pusin e sonde futet lenda plasese e kollones ne sasine e llogaritur per shkiftimin e duher. Pjesa e mbetur e pusit te sondes taposet me pluhur shkambi qe prodhohet gjate shpimit te pusit ose me argjile.

### **Menyra e shperthimit te birave**

Kur ndezja behet me fitil te zakonshem njekohesisht disa mina, gjatesia e tij duhet te jete e tille qe pas ndezjes se minave te para, te mbetet koha e mjaftueshme per ndezjen e minave te tjera dhe per te shkuar zjarrmtari ne vendstrehim.

Llogaritja e gjatesise se fitilit te zakonshem behet nga drejtuesi teknik i punimeve duke marre parasysh numrin e birave dhe largesine e vendstrehimeve. Pavarsisht nga llogaritjet e bera duhet qe gjatesia e fitilit te mos jete me e vogel se 2 m. Kurse fitili qe perdoret per te bere ndezjen e minave nuk duhet te jete me i gjate se 0.5 m. Koha qe harxhohet per ndezjen e minave te zakonshme kontrollohet me ane te fitilit zjarrdhenes i cili duhet te ndizet i pari. Ne rast se zjarrmtarit gjate ndezjes se minave i mbaron fitili ndezes, ai duhet te largohet menjehere per ne vendstrehim edhe ne se nuk ka perfunduar ndezja e te gjitha minave. Ne rastet e shperthimit te minave me plasje te zakonshme behet numurimi i minave qe plasin. Kur ka mina te paplasura afrimi ne frontet e punes lejohet 30 minuta pas plasjes se pusit te fundit.

### Shperthimi me kapsolle elektrike

Kapsollat qe do te perdoren ne plasje u kontrollohet rezistenca para se te perdoren. Kapsollat elektrike qe kontrollohen duhet te futen ne tuba metalike. Pasi matet rezistenca kapsollat duhet te qendrojne pa levizur per 15 sek. Zjarrmtari duhet te pajiset me syza xhami qe nuk thyhen, gjithashtu me ohmmeter matet izolimi kundrejt tokes, i cili duhet te kete rezistence me te madhe se 3500 ohm dhe realizohet ne frontin e punes dhe rezistenca e qarkut e cila duhet ti pergjigjet vleres se llogaritur dhe realizohet ne nje vend te sigurt prej shperthimit te ngarkesave. Vendi me i sigurt eshte vendstrehimi i zjarrmtarit. Seksioni i linjave prej bakri duhet te jete jo me i vogel se 0.75 mm<sup>2</sup>. Rrjeti i shperthimit ne cdo rast duhet te kete dy fije. Te gjitha vendet e lidhjes se percjellesve duhet te izoloohen.

*Kryerja e punimeve me lende plasese ne cdo rast do te behet ne perputhje te plote me kerkesat e rregullores se sigurimit teknik ne pune dhe ne vecanti te rregullores se teknikes se sigurimit per punet me lende plasese.*

#### ID 3.11 | Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerare jometalike.

1. Materiali i copëtuar nga shpërthimi, nëpërmjet mjeteve ngarkuese ngarkohet dhe transportohet për në bunkerin e linjës.
2. Materiali i depozituar në bunker nëpërmjet dozatorit lëviz për në shoshën vibruese të ndarjes së dherave dhe fraksioneve nga 0-5cm. Në këtë operacion pune ndahen nga materiali që shkon për bluarje dherat dhe copat e gurit të thyer me përmasa deri në 5cm. Ky material që quhet tampon përdoret si shtresë mbushëse në punime rruge, bazamente etj.
3. Pas sitjes në shosha vibruese, materiali futet në thesin primar.
4. Nëpërmjet 3 sitave realizohet ndarja e gurit të thyer në 4 fraksione.


### 5.1. Menaxhimi i instalimit

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin në fjalë.

Për zhvillimin e aktivitetit, operatori operon konform të gjithë rregullave teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore.

Puna është organizuar në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organograme, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë e secilit punonjës. Kjo metodë është efektive për realizimin sa më eficient dhe të suksesshëm të punës.

Pak a shumë hierarkia dhe rrjedha e autoritetit tregohet në këtë skemë të thjeshtë, ku çdo gjë varet drejtpërdrejtë nga Administratori i kompanisë.



**Tabela e mëposhtëme jep informacion mbi kushtet e punës.**

<b>KUSHTET E PUNËS</b>					
Numri total i punonjësve	<b>8</b>				
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>3</b>	<b>-</b>
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata		Instalimet		
	<b>1 TURN</b>		<b>1 TURN</b>		
Orët e punës	Zyrat / administrata		Instalimet		
	<b>08<sup>00</sup>-16<sup>00</sup> → 8 orë</b>		<b>08<sup>00</sup>-16<sup>00</sup> → 8 orë</b>		
Numri i ditëve të punës në vit	<b>312</b>				
Numri i orëve në vit	<b>312 ditë/vit x 8 orë/ditë = 2496 orë/vit</b>				
Variacionet sezonale	<b>Nuk preket nga variacione sezonale</b>				
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	<b>Dita e dielë</b>				

## 5.2. Lëndët e para dhe ndihmëse

Aktiviteti është një aktivitet i mirëfilltë prodhimi, prandaj patjetër ka përdorim të lëndëve të para për prodhim, si dhe atyre ndihmëse. Në tabelën më poshtë janë listuar Lëndë të para dhe Lëndë/ materiale ndihmëse që subjekti do të përdorë në funksion të aktivitetit.

Lëndë të para	Lëndë ndihmëse
Guri gëlqeror	Energji elektrike
-	Ujë

## 6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS

### RREZATIMI JONIZUES

\*\*\*Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë rrezatime jonizuese, pasi vetë natyra e aktivitetit nuk shoqërohet me ndikime të tilla.

### NDIKIMET NË POPULLËSI

Qëndra e banuar më afër me sipërfaqen e shfrytëzuar është fshati i Borizanës. Borizana shtrihet në veri-perëndim të qytetit të Krujës dhe ndahet përmes nga aksi i vjetër rrugor Fushë-Krujë – Milot.

*Distancat nga ndërtesat (shtëpi banimi) më të afërta të Fshatit Borizanë me objektin mineral janë:*

- rreth 181 m , 229 m dhe 268 m.

Nisur nga afërsia që objekti ka me disa prej shtëpive të banimit të fshatit Borizanë, referuar dhe faktit që aktiviteti është ekzistues, subjekti duke qenë mjaft i njohur me këtë situatë ka marrë disa masa, me anë të së cilave bëhet i mundur minimizimi i ndikimeve dhe shqetësimeve që mund të sjellë ushtrimi i aktivitetit për banorët e zonës. Masat janë renditur si më poshtë:

- Zhvillimi i aktivitetit brenda orareve të caktuara.
- Të gjitha operacionet që kanë të bëjnë me Lëndët plasëse do të kryhen duke zbatuar me korrektësi pasaportat e shpim-plasjes, si dhe duke garantuar zbatimin me korrektësi të Rregullores së Sigurimit Teknik.
- Plasja do të bëhet vetëm një herë në ditë dhe në një orë të caktuar ku do t'u bëhet e qartë pushtetit lokal dhe banorëve të zonave të afërta.
- Mjetet që do të përdoren për transportin e gurit gëlqeror do t'i nënshtrohen kontrolleve periodike me qëllim mbajtjen në kontroll të gjenerimit të zhurmave prej tyre dhe minimizimit të shkarkimeve në ajër të pluhrave apo gazeve gjatë përdorimit të tyre.

### NDIKIMET NË AJËR

Gjatë aktivitetit në karrierë do të ngrihen pluhra dhe në rast se nuk aplikohet sprucimi me ujë gjatë periudhave me thatësi (në stinën e verës), mund të krijohet një imazh i pakëndëshëm si dhe do të ketë një rritje të sasisë së grimcave të ngurta në ajër gjatë kohës së shfrytëzimit. Përdorimi i mjeteve të transportit mund të jetë një burim gjenerimi gazesh në ajër, por jo në nivele të larta e shqetësuese.

Gjithashtu edhe përdorimi i lëndëve plasëse mund të jetë një burim tjetër i gjenerimit të grimcave të ngurta në ajër.

#### **NDIKIMET NË UJËRA**

Brenda kontureve të vendburimit nuk ka burime uji dhe nuk parashikohet shfaqja e tyre gjatë kryerjes së punimeve të shfrytëzimit.

Nga studimet e ndryshme hidrometereologjike të kryera në zone si dhe nga të dhënat e marra nga objektet që janë në shfrytëzim në afërsi të kësaj zone, arrijme në përfundimin: kushtet hidrogjeologjike të objektit janë të thjeshta me përmbajtje të pakta ujërash nëntokesore, kryesisht të çarjeve të tipit hidrokarbonatik me PH 6,5-7 dhe mineralizim 0,35 gr/liter.

Varferia e botes bimore, ben që ujrën e reshjeve të mos kapen dhe mbahen nga vegjetacioni i ulet (shkurre) dhe rrenjet e bimeve të lenë me pas vendin infiltrimit të ujit në nëntokë.

Në zonën e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të rëndësishme të identifikuar. Duke iu referuar ASIG Geoportal, vërehet një distancë e konsiderueshme e burimeve ujore nga zona e shfrytëzimit, përkatësisht:

- **1.26 km nga Liqeni Borizanë**
- **2.02 km nga Lumi i Drojës**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti, ndikimet në ujëra do të jenë minimale. Ky aktivitet nuk do të shoqërohet me shkarkime në ujërat e zonës. Kjo për vetë faktin se uji gjatë proceseve të punës mund të përdoret vetëm gjatë periudhave të thata të verës, duke u sprucuar për të miniizuar përhapjen e pluhrave në ajër. Por vlen të theksohet se sprucimi me ujë do të kryhet gjithmonë pa krijuar rrjedha ujore.

Prandaj, referuar shpjegimit të mësipërm vlerësohet se nuk do të ketë ndikime në ujëra.

#### **NDIKIMET NË TOKË**

Përdorimi i tokës, duke iu referuar edhe ndërtimit gjeologjik, kryesisht përbëhet nga gurë gëlqerorë, prandaj zhvillimi i një aktiviteti të tillë në këtë sipërfaqe është mëse i pranueshëm. E gjithë zona në fjalë, prej shumë vitësh shfrytëzohet për nxjerrjen e gurit gëlqeor. Duke qenë se zhvillimi i aktivitetit kërkon shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës, gjatë zhvillimit të tij patjetër që do të ketë ndikimet mbi mjedisin tokësor edhe pse nuk do të kenë impakte tepër të mëdha për faktin e cituar më lart (që është një sipërfaqe toke e shfrytëzuar për këtë qëllim prej vitësh).

Impakti kryesor gjatë shfrytëzimit dhe pas përfundimit të procesit të shfrytëzimit lidhet me eliminimin e plotë të mbulesës bimore autoktone.

Impakti i dytë lidhet me largimin e shtresës (cipës) aktive të tokës pjellore, e cila shtrihet në sipërfaqen e tokës dhe përbën substraktin e vetëm të gjallërimit të jetës në hapësirën e fokusuar të gurores.

Ndikimi vijues lidhet gjithashtu me modifikimin e përgjithshëm të peisazhit si rrjedhojë e ndryshimit të relievit dhe zhveshjes totale të sipërfaqes nga mbulesa bimore indigjene.

*Por për minimizimin e këtyre ndikimeve, subjekti do të rehabilitojë sipërfaqen e shfrytëzuar. Për rehabilitimin e tokës, do të shfrytëzohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do të plotësohet me 30 cm dhë (toke) të pasur me pleh. Përpunimi, sistemimi, mbushja dhe rigjenerimi i saj do të vazhdojë çdo vit.*

#### **NDIKIMET NË HABITATE DHE BIODIVERSITET**

Ndikimi kryesor dhe më i rëndësishëm në mjedisin biologjik është gjatë fazës së punimeve për hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës sipërfaqësore. Nga zbatimi i këtij projekti pritet të ketë një efekt domethënës në dëmtimin e bimësisë së zonës, ndonëse nuk kemi të bejmë me një zonë me bimësi të lartë, por kryesisht shkurre e barishtore.

Dëmtimi i sipërfaqes së tokës dhe i shtresës bimore, të cilat shërbejnë si habitat për një sërë gjallësash, do të ndikonte edhe në largimin e faunës së zonës. Kryesisht kafshët e egra, zogjtë, insektet dhe zvarranikët.

Gjenerimi i zhurmave do të ndikojë gjithashtu në largimin e faunës, kjo kryesisht nga aktiviteti i përdorimit të lëndëve plasëse.

#### **NDIKIMET NË KLIMË**

\*\*\*Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.

#### **MENAXHIMI I MBETJEVE**

##### **MBETJE JO TË RREZIKSHME URBANE**

Nga zhvillimi i aktivitetit të punonjësve, do të gjenerohen mbetje urbane me kod 20. Këto mbetje do të vendosen në kontenierë (kosha) brenda territorit të aktivitetit, për t'u depozituar më pas në vendet e përbashkëta të përcaktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Kontenierët do të jenë me ngjyra, në mënyrë që mbetjet të ndahen që në burim, gjithashtu ato do të jenë të mbyllur, për të evituar përhapjen e aromave të pakëndëshme, sidomos në kohë me temperatura të larta dhe në kontakt me lagështirën.

##### **MBETJE NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT**

Nga ky aktivitet, do të gjenerohen 'mbetje' të ngurta nga materialet tokësore (shtresa aktive e tokës në një trashësi 30-40cm), gjatë gërmimeve të hapjes së karrierës. Këto mbetje do të grumbullohen në një shesh të lirë të përcaktuar nga drejtuesi teknik dhe do të ruhen, me qëllim përdorimin e tyre gjatë punimeve të rehabilitimit të objektit mineral.

Ndërsa përsa i përket mbetjeve sterile nga guri, nuk do të ketë, sepse i gjithë materiali do të ngarkohet direkt në mjetet e transportit për t'u përdorur nga klientët sipas kontratave që do nënshkruajë subjekti. Cilësia e materialit tokësor është e atillë që nuk gjeneron mbetje.

Pra për sa më lart, nuk do të ketë ndikime nga mbetjet e prodhuara, pasi për vetë tipologjinë e tyre, ato do të ripërdoren në çdo rast.

#### **NDIKIMET NGA ZHURMAT DHE VIBRIMET**

\*\*\* Zhurmat janë normale për një aktivitet të tillë. Kryesisht zhurmat do të gjenerohen nga përdorimi i lëndëve plasëse dhe gërmimet e masivit të shkëmbit, si dhe nga mjetet e transportit, por që nuk do të jenë shqetësuese për zonat e banuara që ndodhen në afërsi të objektit mineral. Kjo edhe për faktin se subjekti ka zhvilluar aktivitetin duke respektuar të gjithë protokollet për shpim-plasjet.

Ai ka ndjekur dhe do të vazhdojë të ndjekë masat e mëposhtëme, me qëllim operimin sa më të mirë dhe efektiv të aktivitetit e pa ndikime në mjedis dhe në zonat e banuara:

- Të gjitha operacionet që kanë të bëjnë me Lëndët plasëse do të kryhen duke zbatuar me korrektësi pasaportat e shpim-plasjes, si dhe duke garantuar zbatimin me korrektësi të Rregullores së Sigurimit Teknik.
- Plasja do të bëhet vetëm një herë në ditë dhe në një orë të caktuar ku do t'u bëhet e qartë pushtetit lokal dhe banorëve të zonave të afërta.

- Mjetet që do të përdoren për transportin e gurit gëlqeror do t'i nënshtrohen kontrolleve periodike me qëllim mbajtjen në kontroll të gjenerimit të zhurmave prej tyre dhe minimizimit të shkarkimeve në ajër të pluhrave apo gazeve gjatë përdorimit të tyre.

*Subjekti do të respektojë vlerat e lejuara të zhurmave dhe do të funksionojë brenda fashës orare të përcaktuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr.2, Datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive Ekonomike-Shoqërore".*

**Vibrimet** – Mund të jenë prezente vetëm gjatë procesit të përdorimit të lëndëve plasëse dhe gjatë shkëputjes së masivit shkëmbor. Ndikimi i tyre varet nga drejtuesi teknik, i cili duhet të ruajë nivelin e përdorimit të lëndëve plasëse, si dhe duhet të përcaktojë mirë fashën orare gjatë së cilës duhet të përdoren lëndët plasëse.

#### **NDIKIMET E AKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT MBI NDËRTIMET, TRASHËGIMINË ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA**

\*\*\*Aktiviteti që do të ushtrojë shoqëria do të zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera. Kjo tregon që zona është e lirë për të realizuar këtë aktivitet dhe që zhvillimi i aktivitetit nuk ndikon në këto zona si në përmirësim apo përkeqësimin e tyre.

Zona ku do të zhvillohet projekti nuk bën pjesë në asnjë kategori të Zonave të Mbrojtura dhe nuk mbart vlera kulturore dhe historike për vendin.

Duke iu referuar ASIG Geoportal, vërehet një distancë e konsiderueshme e Zonave të Mbrojtura nga zona e shfrytëzimit, përkatësisht:

- 3.86 km nga Peisazhi i Mbrojtur Krastë-Verjon
- 4.37 km nga Parku Kombëtar Mali i Dajtit

#### **NDIKIMET E AKTIVITETIT NË RRUGËT LOKALE DHE TRANSPORTIN**

Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do ketë ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirëmbajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarëvajtjes sa më të mirë të aktivitetit të tij.

#### **NDIKIMI SOCIAL-EKONOMIK**

Ndikimi në mjedisin social-kulturor dhe ekonomik nga faza e zbatimit të punimeve të shfrytëzimit të mineraleve, vlerësohet të jetë pozitiv. Kjo për shkak të rritjes së punësimit të individëve lokalë në objektin e shfrytëzimit. Sipas traditës së zonës banorët pranë qendrave të banuara kanë punuar prej vitesh në gurorë.

Përsa i përket distancës me qendrat e banuara, qendra e banuar më afër me sipërfaqen e shfrytëzuar është fshati i Borizanës. Distanca nga ndërtesat (shtëpitë e banimit) më të afërta të fshatit Borizanë me objektin minerar janë rreth 181m , 229m dhe 268m.

## 7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS

	EFKËTET E MUNDSHME	MASAT ZBUTËSE
1	Emetimet në ajër	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do të përdoren pajisje dhe mjete pune me kushte të mira teknike.</li> <li>- Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme do të bëhet kontrolli i kushteve teknike të këtyre mjeteve për të shmangur dhe parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve në mjedis, emetimin e elementëve ndotës të gaztë, si dhe për parandalimin e ndonjë avarie të mundshme teknike.</li> <li>- Do të aplikohen sprucime për minimizimin e përhapjes së pluhrave.</li> </ul>
2	Zhurmat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punonjësit të pajisen me të gjitha mjetet për mbrojtjen nga rritja e nivelit të gjenerimit të zhurmës.</li> <li>- Nga ana e subjektit të bëhet kontrolli në mënyrë të vazhdueshme të mjeteve të punës, me qëllim reduktimin e gjenerimit të zhurmave.</li> <li>- Drejtuesi Teknik ka një rol të veçantë dhe kryesor në menaxhimin e përdorimin e lendeve plasëse (njoftimi I instancave përkatëse për ditën dhe orën kur do të përdoren lëndët plasëse)</li> <li>- Subjekti siguron zbatimin e normave dhe dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me zhurmat.</li> </ul>
3	Shkarkimet në ujëra	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i spërkatjes me ujë për minimizimin e pluhrave gjithmone pa krijuar rrjedha ujore.</li> <li>- Përdorimi i ujit me sa më shumë efikasitet, vetëm në rastet e domosdoshme si psh gjatë periudhës së verës.</li> <li>- Mirembajtja e rrjeteve të drenazhimit të ujerave të shiut.</li> </ul>
4	Flora/Fauna	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duke u bazuar në tipologjinë e aktivitetit, nuk pritet të shkaktohen ndikime negative në mjedis dhe në biodiversitetin e zonës, apo të ndikojë në humbjen dhe fragmentarizimin e habitateve.</li> <li>- Subjekti gjatë shfrytëzimit do rehabilitojë sipërfaqen e shfrytëzuar sipas planit të rehabilitimit që ka hartuar.</li> <li>- Subjekti do të mbajë nën kontroll gjenerimin e zhurmave dhe vinimeve, në mënyrë që të shmangët shqetësimi i faunës së zonës.</li> </ul>
5	Mbetjet e ngurta	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në fund të ditës së punës mbetjet e krijuara do të grumbullohen dhe do të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Pushteti Vendor.</li> <li>- Sasia e sterileve të gjeneruara të grumbullohen në shesh- depozitimet brenda kufijve të territorit të</li> </ul>

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT K64818201U**

		objektit minerar dhe te perdoren per rehabilitimin e objektit minerar.
6	Rastet aksidentale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjetet te kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikante apo karburant.</li> <li>- Shoqëria siguron se do të ketë ndërhyrje të menjëhershme nëse do të ketë ndikime negative në mjedis.</li> </ul>
7	Ndikimi social	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga zhvillimi i aktivitetit pritet të ketë ndikim pozitiv në aspektin socio- ekonomik.</li> <li>- Do të bëht punësimi i punëtorëve nga zona përreth, si rrjedhoje do te kete ndikim pozitiv ne aspektin ekonomik te zones.</li> </ul>
8	Avari te mundshme (Zjarr, aksidente)	<p><b><i>Për rastet e zjarreve nga mjetet e punës apo shkaqe njerëzore:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ne ambientet e aktivitetit do te vendoset nje kend i posacem dhe i dukshem, ne kuti prej druri te mbyllur me xham dhe te lyer me boje te kuqe, do të vendosen mjetet e MKZ te perbera nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zjarrefikesi me shkume;</li> <li>• Hidrante me ujë</li> <li>• Vegla pune si kove, Kazem, sopate etj.</li> </ul> </li> </ul> <p><i>Gjithashtu sektori disponon dhe mjete emergjence si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Barrele universal;</li> <li>• Respirator;</li> </ul> <p><b><i>Për rastet e zjarreve në zonat pyjore, subjekti ka marrë këto masa:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbulimi në kohë i zjarrit.</li> <li>• Transferimi i Informacionit mbi zjarrin. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera. Punonjësit e karrierës të cilët zbulojnë zjarre në zonën pyjore duhet të njoftojnë në nr. e tel. 128 Shërbimin Zjarrfikës.</li> <li>• Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim, ku materiali i tokës përdoret si izolator, pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë, përkatësisht energjia termike për djegien e drurit.</li> <li>• Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.</li> </ul>

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT K64818201U**

9	Ndihma e shpejte	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Te vendoset kutia e ndihmes se shpejte, me te gjitha barnat e percaktuara me ligj, per mjekime te emergjences, ne castin e duhur.</li> <li>- Per perdorimin e saj duhet te jete I punesuar edhe nje infermier.</li> </ul>
10	Perdorimi i lendeve plasese	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perdorimi i lendeve plasese do te menaxhohet dhe do te jene nen mbikeqyrjen e drejtuesit Teknik i cili siguron se do te zbatohen me perpikmeri dhe rigozitet te gjitha dispozitat ligjore per perdorimin e lendeve plasese.</li> <li>- Do te behen te gjitha raportimet e nevojshme nga ana e personelit mbi menyren dhe sasine e perdorimi te te lendeve plasese.</li> <li>- Subjekti ka hartuar nje plan te emergjencash dhe siguron se do te zbatohen te gjitha udhezimet e percaktuara ne ate plan.</li> </ul>
12	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te rikonstruksionit dhe atyre te reja do te limitohet brenda siperfaqes se kerkuar.</li> </ul>

## 8. MONITORIMI

Plani i monitorimit në mjedis do të konsistojë në:

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	KUSH?
1.	Monitorim i cilësisë së ajrit	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
2.	Monitorim i zhurmave	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
3.	Sasia e mbetjeve të gjeneruara	Në varësi të punës	Operatori
4.	Monitorim I gjendjes teknike të pajisjeve operuese	Çdo 1 vit	Operatori ose Teknikë të posatshëm

**“EDILE VESELI – COSTRUCSION”**

**SHPK**

*Administrator*

**Agim veseli**

  
**EDILE VESELI - COSTRUCSION (SHPK)**  
 Adresa - Burizane - KRUIJE  
 Administrator: AGIM VESELI  
 Numer ( NIPT) K 64818201 U